



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:047354

Datë: 12.08.2022

Numri i dokumentit: 03331995

PKR.nr.102/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Merita Xharavina, zyrtare ligjore e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vrasjes, në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.72/2022 të datës 15.07.2022, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 27.07.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj-H.i, të akuzuarit D. K.dhe mbrojtëses së tij, av. Teuta Zhinipotoku me seli në Prishtinë, me datë 02.08.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.08.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

D. K., nga i ati M. dhe e ëma H., e gjinisë G., data e lindjes . . . , në fshatin . . . , Komuna e Rahovecit, tani me banim në Gjakovë, rr. ”. . . , me nr. personal . . . , ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion mjeshtrë, i martuar, i ati i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse, me datë 09.03.2022, rreth orës 18:40 minuta, në Gjakovë, Rr. ”. . .”, me dashje ka tentuar të privojë nga jeta, këtu të dëmtuarin B. M., në atë mënyrë që si shkak i xhelozisë për lidhjen dashurore në mes të gruas së tij me të dëmtuarin, i pandehuri paraprakisht përgatitet për ta kryer veprën duke siguruar armën automatike ASH-78, tip 1, kalibër 7.62mm, me numër serik 074793-89, prodhim i Shqipërisë, pastaj shkon dhe pret të dëmtuarin në afërsi të kompanisë së

këtij “. . .”, dhe me të vërejtur të dëmtuarin që del nga zyra e tij shtënë shtatë herë në drejtim të trupit të tij dhe atë në regjionin publik dhe regjionin e majtë vektor si dhe kërcyerin e këmbës së djathtë dhe kofshën e majtë, ku si pasojë e lëndimeve të pësuarra i dëmtuari rrëzohet në tokë, fillimisht dërgohet në spitalin Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë, e më pas për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore i njëjti dërgohet në QKUK Prishtinë për trajtim mjekësor, ku nga të shtënat i janë shkaktuar dëmtime të rënda trupore të rrezikshme për jetën dhe me pasoja të përhershme për shëndetin.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vrasjes, në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

II

Sepse, nga data e pavërtetuar deri me datë 09.03.2022, në banesën e tij, rr. “. . .”, në Gjakovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit mbi armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që pas marrjes së informatave nga policia se i pandehuri posedon armë me të cilën kishte shtënë në drejtim të dëmtuarit B., në mënyrën e cekur si në pikën I, ashtu që nga ana e zyrtarëve policor pas arritjes në banesën e tij, është gjetur arma automatike ASH-38, tip 1, kalibër 7.62mm, me numër serik 074793-89, prodhim i Shqipërisë, një karikator dhe 23 fishek të kalibrit 7.62x39 mm dhe e njëjta armë është sekuestruar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit D. K., për secilën veprë penale veç e veç, i'a:

PËRCAKTON DËNIMET

Për veprën penale si në pikën e I-rë, të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve dhe

Për veprën penale si në pikën e II-të, të dispozitivit të aktgjykimit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Andaj, gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40 paragrafi 1 pika 1.2, 42, 69 dhe 70, si dhe nenit 172 lidhur me nenin 28 dhe nenit 366 paragrafi 1 dhe 3 të KPRK-së (Kodi Nr. 06/L-074), si dhe neneve 245, 248, 360, 361, 365 dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarin e:

GJYKON

Me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) vite e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 09.03.2022, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ndaj të akuzuarit, bëhet konfiskimi i: armës automatike ASH-38, tip 1, kalibër 7.62mm, me numër serik 074793-89, prodhim i Shqipërisë, një karikator dhe 23 fishek të kalibrit 7.62x39 mm, sipas listës së armëve të sekuestruara, me nr. të rastit 2022-EA-300, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

I akuzuari obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë:

- në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej njëzet (20) Euro;
- në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) Euro dhe
- në emër të kompensimit të viktimave të krimit, shumë prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B. H. M. nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasuror-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

1. Pjesa hyrëse e arsyetimit të aktgjykimit

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën, PP/L.nr.72/2022 të datës 15.07.2022, ndaj të pandehurit D. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të vrasjes, në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe të njëjtën e ka dorëzuar në gjykatë, me datë 15.07.2022.

Gjykata, me datë 27.07.2022, si gjykatë me kompetencë lëndore dhe territoriale, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë marrë pjesë: Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj H.i, i akuzuari D. K. dhe mbrojtësja e tij Teuta Zhinipotoku, avokate nga Prishtina, si dhe i pandehuri L. M., së bashku me mbrojtësin e tij, av. Ndreçë Dodaj, nga Gjakova.

Meqenëse i pandehuri D. K., e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, ndërsa i pandehuri L. M. nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë së të pandehurit të parë dhe e ka veçuar procedurën penale në këtë çështje penale.

Prokurorja e shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

2. Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit ia ka dhënë mundësinë që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë, por paraprakisht ia ka tërhequr vërejtjen lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që ngarkohet.

I akuzuari D. K., pas konsultimit me mbrojtësen e tij, ka deklaruar, se: e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, është penduar për gabimin që e ka bërë dhe e pranon fajësinë për të dy veprat penale.

Mbrojtësja e të pandehurit D. K., av. Teuta Zhinipotoku, ka deklaruar se: gjatë kësaj seance i pandehuri D. K. e ka pranuar fajësinë për të dy veprat penale për të cilat akuzohet si në aktakuzë, të ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, andaj, meqë i njëjti e ka pranuar fajësinë, e ka lutur gjykatën që gjatë shqiptimit të dënimit ta ketë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri në seancën fillestare, pendimin e tij për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, gjendjen psikike të tij në momentin e shkaktimit të kësaj vepre penale si dhe të ketë parasysh se është baba i dy fëmijëve dhe deri te vepra penale ka ardh atëherë kur i njëjti nuk i ka menduar pasojat për kryerjen e të njëjtës. Andaj, e ka lutur gjykatën që të njëjtit ti shqiptojë një dënim sa më të ulët, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe mundësitë që ofrohen me rastin e pranimit të fajësisë në seancën fillestare. Po ashtu, ka shtuar se i mbrojturi i saj pasi që e ka kryer veprën është lajmëruar vet në polici.

3. Deklarimet e palës lidhur me pranimin e fajësisë

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj H.i, duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit D. K. ka deklaruar se: pajtohet me pranimin e fajësisë së bërë nga këtu i pandehuri D., për veprat penale për të cilat akuzohet për faktin se ky pranim fajësie është në përputhje të plotë me provat mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza, ku edhe gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë të bërë nga i njëjti, ta aprovojë.

4. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenet 246 dhe 248 par. 1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues sidomos duke u mbështetur në vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka aprovuar pranimin e fajësisë së të njëjtit dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprat penale: vrasje, në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e ka marrë në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Njoftim mbi urdhër kontrollin, i dt.10.03.2022;
- Raport i hetuesit L.Z., i dt.09.03.2022;

- Vërtetim mbi konfiskim, i dt.09.03.2022;
- Raport i hetuesit D. B., i dt.10.03.2022;
- Raport i hetuesit G. L., i dt.09.03.2022;
- Vërtetim mbi konfiskimin, i dt.10.03.2022;
- Raport i policit E. K., i dt.09.03.2022;
- Raport i policit A. L., i dt.09.03.2022;
- Raporti i hetuesit D. B., i dt.15.03.2022;
- Vërtetim mbi kthimin e sendeve, i dt.18.03.2022;
- Raporti i ekspertimit AKF/2022-1249/2022-1202,
- Fletëlëshimi me nr.2138, i dt.29.04.2022;
- Fletëlëshimi me Epikrizë me nr.100/2022, i dt.16.03.2022, si dhe raporti mjekësor me nr.2842 për të dëmtuarin B. M.,
- Raporti mjekësor me nr.2852, në emër të pandehurit D. K.,
- Akt ekspertimi mjeko ligjor, i dr. F. B., i dt.08.06.2022;
- Deklarata e dëshmitarit A. O. e dhënë në polici, me dt.18.03.2022;
- Deklarata e dëshmitarit A. K. e dhënë në polici, me dt.21.03.2022;
- Lista e dëshmive e dt.09.03.2022;
- Raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i dt.13.08.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit B. M. e dhënë në Prokurori, me dt.19.05.2022;
- Deklarata e dëshmitares G. K. e dhënë në Prokurori, me dt.26.04.2022;
- Deklarata e të pandehurit L. M. e dhënë në Prokurori, me dt.19.05.2022, në praninë e mbrojtësit, av. Ndrecë Dodaj;
- Deklarata e të pandehurit D. K. e dhënë në Prokurori, me dt.30.05.2022, në praninë e mbrojtësit, av. Teuta Zhinipotoku;
- CD-ja me video incizim nga zyra e “. . .”, si dhe
- Fotografitë dhe shkresat e tjera në lëndë.

Prandaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimi të fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në dispozitivin I dhe II, të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij, me ç’rast përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i akuzuari i lartcekur, është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

5. Gjetjet e Gjykatës lidhur me llojin dhe masën e dënimit si dhe lidhur me konfiskimin

Gjykata, gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara në nenet 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese, gjykata për të akuzuarin, ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, pasi që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t’i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, pastaj si rrethanë tjetër rënduese ka gjetur intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës së mbrojtur, ku i pandehuri ka shtënë me armë në të dëmtuarin shtatë herë dhe si rezultat ka pësuar

lëndime të rënda trupore me pasoja të përhershme për shëndetin e tij, të cilat lëndime kanë qenë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tij në momentin e shkakimit.

Gjykata, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarit, është i martuar, i ati i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe ka shprehur gatishmëri të lartë për bashkëpunim, si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën, me ç'rast e ka pranuar fajësinë, pendimin e thellë për veprimet e tij e sidomos si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë që nga fillimi i kësaj procedure penale, pendimin, e në veçanti premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën penale.

Andaj, duke i pasur parasysh të lartcekurat, si dhe rrethanat në të cilat i akuzuari i ka kryer veprat penale, gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe është e bindur se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, dhe i njëjti është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari, si dhe konsiston në parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, rehabilitimin e tyre, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 282 paragrafi 1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPPRK-së, dhe nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm, dhe atë: armën automatik ASH-78, tip 1, kalibër 7.62mm, me numër serik 074793-89, prodhim i Shqipërisë, një karikator dhe 23 fishek të kalibrit 7.62x39 mm.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sendet e konfiskuara do të shkatërrohen në rast se nuk evidentohet se të njëjtat janë përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i akuzuari në kundërshtim ligjor me nenin 4 par.1 nën par.1.1 pika 1.1.2 të Ligjit për Armët (Ligji Nr.05/L022).

6. Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.6, lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

7. Arsyet lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit, që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në kontest të rregullt juridiko-civil, bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.102/2022 datë 12.08.2022

Zyrtarja Ligjore,
Merita Xharavina

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Ilir I. Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.